



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

### th ë r r e t

mbledhjen e **katërt** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **04.08.2020** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e objektit të vjetër të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

### REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Raporti vjetor i NPL “Pallati i Rinisë” SH.A për vitin 2019;
4. Raporti vjetor i NPL “ Termokos” SH.A për vitin 2019;
5. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill – 30 qershor 2020 (TM2);
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Sima Com dhe Adnan (Ali) Memedali;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut;
8. Propozimvendimi për për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica;
9. Propozimrregullorja për definimin e parametrave urban-arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese;
10. Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019 – 2021;
11. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike;

12. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019;
13. Informatë nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në Komunën e Prishtinës;
14. Të ndryshme.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-060/01-130787/20, më 30.07.2020

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
Agim Kuleta